



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. 238/6 Prot

Shkodër, më 13.12.2021

**URDHËR**

Nr. 1286 date 13 / 12 2021

Për

“Miratimin e rregulloreve të Njesisë Përgjegjëse të Sinjalizimit”


Bazuar në shkronjën “a”, neni 64, të Ligjit nr. 139/2015, Për Vetëqeverisjen vendore”, pika 10 neni 13, të Ligjit nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve” si dhe kërkesën e paraqitur nga Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit – Bashkia Shkodër,

**U R D R E R O J:**

1. Miratimin e rregullores “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit ne Bashkinë Shkodër”, sipas tekstit të bashkëlidhur.
2. Miratimin e rregullores “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Shkodër “, sipas tekstit të bashkëlidhur.
3. Ngarkohet Njësia e Sinjalizimit për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër hyri në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Voliana ADEMI**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit**

---

**RREGULLORE**

**PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E  
KONFIDENCIALITETIT NË NJËSINË PËRGJEGJËSE TË SINJALIZIMIT**

**BASHKIA SHKODËR**

**KREU I**

**REGULLA TË PERGJITHSHME**

**Neni 1**

**Baza ligjore**

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në bashkinë Shkodër, bazohet në ligjin nr. 60/2016 "*Per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*", aktet nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

**Neni 2**

**Objekti**

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "*Per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*".

### Neni 3

#### Perkufizime

Ne kete Rregullore termat e meposhtem kane keto kuptime:

1. "I sinjalizuar" jane nje ose me shume persona, ndaj te cileve behet nje sinjalizim, sipas ligjit nr. 60/2016, ne lidhje me nje veprim ose praktike te dyshuar korrupsioni.
2. "Njesia pergjegjese" eshte organi i posacem, i ngritur, brenda Bashkisë Shkodër I perbere Drejtuesi I Njesisë Auditit Brendshëm dhe një Audit dhe të ngarkuar me detyren e shqyrtimit te hetimit administrativ te sinjalizimit dhe shqyrtimin e kerkeses per mbrojtjen e sinjalizuesit.
3. "Organizate" eshte Bashkia Shkodër dhe institucionet e vartësisë nën 80 punonjës.
4. "Korrupsion" eshte cdo veprim ose mosveprim i kunderligjshem, sipas legjislacionit penal ne fuqi, ne lidhje me cdo forme te korrupsionit aktiv, korrupsionit pasiv, shperdorimit te detyres ose kompetencave, ushtrimit te ndikimeve te paligjshme ne kryerjen e detyrave ose marrjen e vendimeve, shperdorimit te te ardhurave te Buxhetit te Shtetit, perfitimit te paligjshem te interesave, si dhe cdo akt tjetër i ngjashem me to. "Sinjalizim" eshte raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njesia pergjegjese ose ILDKPKI-ja per veprime apo praktika te dyshuara korrupsioni, te kryera ne vendin e tij te punes.
5. "Sinjalizues" eshte individi, i cili aplikon ose eshte ne marredhenie pune, ose ka punuar me pare prane bashkisw Shkodwr, pavaresisht nga natyra e marredhenies se punes ose kohezgjatjes se saj, si dhe nese paguhet ose jo, qe sinjalizon nje veprim ose praktike te dyshuar korrupsioni.
6. "Veprim ose praktike e dyshuar korrupsioni" eshte nje veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana te kryera ne nje organizate, per te cilat sinjalizuesi dyshon ne mirebesim, sipas ketij ligji, se mund te perbeje korrupsion.
7. "ILDKPKI" eshte Inspektorati i Larte i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe

Kontliktit te Interesave.

## KREU II

### PROCEDURA E HETIMIT ADMINISTRATIV TE SINJALIZIMI

#### Neni 4

##### Parimet e pergjithshme

1. Njesia pergjegjese per zbatimin e ligjit nr. 60/2016 "Per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" duhet:
  - a. te veproje me ndershmeri, paanshmeri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitime te sinjalizuesit;
  - b. te veproje ne menyre te pavarur nga pikepamja politike dhe cdo influence tjeter e padrejte qe mund te pengoje realizimin e detyrave, sipas ketij ligji;
  - c. te shmange cdo konflikt interesi te mundshem dhe te deklaroje menjehere tek Bashkia Shkodër, konfliktin e interesit perpara fillimit te hetimit administrativ te nje sinjalizimi;
  - d. te marre te gjitha masat e pershtatshme per te mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime te tjera te cilat synojne asgjesimin e tyre;
  - e. te ruaje konfidencialitetin e informacionit dhe te mbroje te dhenat ne permbajtje te cdo sinjalizimi, ne perputhje me nenet 15 dhe 16 te ketij ligji;
  - f. te ruaje sekretin shteteror ne permbajtje te nje sinjalizimi ne zbatim të ligjit.
2. Veprimet procedurale te njesise pergjegjese kryhen ne perputhje me ligjin nr. 60/2016 dhe ne rast te mosparashikimit nga ky ligj, sipas Kodit te Procedurave Administrative.
3. Gjate procesit te hetimit administrativ, sinjalizuesi ka te drejte te mos zbuloje burimet e informacionit.

#### Neni 5

Forma dhe permbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi behet me cdo mjet komunikimi ne forme te shkruar ose deklarohet

verbalisht prane njesise pergjegjese e cila detyrohet ta dokumentoje me shkrim ate me ane te nje procesverbali.

2. Sinjalizimi permban te pakten:

- a. te dhenat e identitetit te sinjalizuesit;
- b. te dhenat e kontaktit te sinjalizuesit;
- c. pershkrimin e fakteve dhe rrethanave per te cilat eshte ne dijeni sinjalizuesi per veprimin ose praktiken e dyshuar te konupsionit, shoqeruar me provat perkatese, per aq sa eshte e mundur;
- d. referimin perkates ne Kodin Penal te Republikes se Shqiperise, per aq sa eshte e mundur nga sinjalizuesi, te vepres ose praktikes se dyshuar te korrupsionit;
- e. ne rastin e sinjalizimit te jashtem, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, per aq sa eshte e mundur nga sinjalizuesi, per perdorimin e mekanizmit te sinjalizimit te jashtem,

3. Sinjalizuesi mund te zgjedhe te mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga njesia pergjegjese si i tille, vetem nese ne te jane shprehur qarte dhe jane arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe te dhenat e sinjalizuara sigurojne nje haze te mjaftueshme per te hetuar administrativisht veprimin ose praktiken e dyshuar te korrupsionit,

4. Njoftimet per veprimet procedurale, per te cilat njesia pergjegjese cakton afate, duhet te permbajne paralajmerimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit te afatit.

5. Ne rastet kur sinjalizimi nuk eshte depozituar sipas formes dhe permbajtjes se kerkuar ne piken 2 te ketij neni, njesia pergjegjese i kerkon me shkrim sinjalizuesit te korrigjije keto te meta brenda 7 diteve nga data e marrjes se njoftimit per korrigjim.

## **Neni 6**

### **Regjistrimi i sinjalizimit**

1. Sinjalizimet regjistrohen ne nje regjister te posacem protokolli dhe elektronik te

krijuar per kete qellim

2. Njesia pergjegjese nuk mund te refuzoje per asnje shkak regjistrimin e sinjalizimit.

#### **Neni 7**

Rastet e konfliktit te interesave

1. Ne rastet kur anetari i njesise pergjegjese konstaton apo vihet ne dijeni se ai vete apo persona te lidhur me te perfshire ose kane nje interes te drejtperdrejte ose jo te drejtperdrejte, pasuror ose personal ne veprimin ose praktiken e dyshuar te korrupsionit, detyrohet qe te shmange kete konflikt interesi duke e deklaruar menjehere ate tek Bashkia Shkodër, perpara se te filloje hetimi administrativ i sinjalizimit.
2. Titullari i Bashkisë Shkodër, brenda 5 diteve nga njoftimi, urdheron zevendesimin e anetarit te njesise pergjegjese per kete hetim administrativ me nje tjetër punonjës te njesise se auditimit te brendshem.

#### **Neni 8**

**Mosfillimi i hetimit administrativ**

1. Njesia pergjegjese ka te drejte te mos filloje hetimin administrativ nese:
  - a. sinjalizimi nuk eshte korrigjuar sipas percaktimeve te pikes 5 te nenit 5 te kesaj Rregulloreje;
  - b. sinjalizimi permban fakte dhe rrethana qe nuk perbejne korrupsion sipas percaktimit te bere ne piken 4 te nenit 3 te kesaj Rregulloreje;
  - c. kur nga permbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente te kundervajtjes administrative ose te vepres penale.
2. Mosfillimi i hetimit administrativ behet me vendim te arsyetuar te njesise pergjegjese.

#### **Neni 9**

**Procedura e hetimit administrativ**

1. Njesia pergjegjese heton administrativisht sinjalizimin, ne perputhje me

proceduren e percaktuar ne ligjin nr. 60/2016. Per aq sa nuk parashikohet ndryshe ne kete ligj, njesia pergjegjese zbaton dispozitat e Kodit te Procedurave Administrative.

2. Njesia pergjegjese ka te drejte te kerkoje infomacione dhe dokumente, te urdheroje inspektive ose analiza, te mbledhe deklarata ose te pyese persona ne dijeni ose rrethanat e ceshtjes ose te konsultohet me eksperte te fushave te ndryshme.
3. Ne hetimin administrativ merr pjese sinjalizuesi dhe cdo person tjetër i trete, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni per rrethanat e sinjalizuara, perfshire dhe te sinjalizuarin, nese vleresohet e nevojshme nga njesia pergjegjese,
4. Seciles pale pjesemarrrese ne hetimin administrativ i garantohet e drejta per nje proces te rregullt, ne perputhje me parashikimet ne Kodin e Procedurave Administrative. Gjate procesit te hetimit palet kane te drejte:
  - a. te paraqesin prova te cilat kane vlere per ceshtjen;
  - b. te konsultohen me dosjen e hetimit;
  - c. te degjohen ne lidhje me pretendimet personalisht ose nepermjet nje perfaqesuesi.

## **Neni 10**

### **Provat**

1. Palet jane te detyruar te paraqesin informacione, prova, dokumente, deklarata apo per t'u paraqitur personalisht perpara njesise pergjegjese sa here qe u kerkohet. Cdo shkelje e ketij detyrimi nga ana e zyrtareve apo organizatave private perben shkak per fillimin e procedimit ligjor ne varesi te shkeljes se konstatuar.
2. Njesia pergjegjese ka detyrimin te dokumentoje me shkrim cdo veprim qe kryen gjate hetimit administrativ. Procesverbali duhet te nenshkruhet nga te gjithë anetaret e njesise pergjegjese.
3. Njesia pergjegjese eshte e detyruar te regjistroje cdo prove te paraqitur nga palet dhe te arsyetoje vendimin e mospranimit te tyre nese vlereson se prova e paraqitur nuk ka vlere per ceshtjen. Kunder ketij vendimi mund te behet verejtje me shkrim, kopje e se cites i bashkelidhet aktit. Dokumentet e nevojshme per

hetimin pranohen nga njesia pergjegjese pa pagese.

### **Neni 11**

#### **Mjetet e kerkimit te proves**

1. Gjate hetimit administrativ njesia pergjegjese, me qellim percaktimin e gjendjes se fakteve dhe rrethanave qe kane lidhje me ceshtjen, mund:
  - a. te mbledhe deklarata nga palet, deshmitaret dhe eksperte;
  - b. te marre dokumente dhe dokumente te tjera te dokumentuara nepermjet mjeteve fotografike, te regjistrimit ose mjeteve te tjera teknike;
  - c. te keqyre vende te caktuara;
  - d. te perdore te gjitha mjetet dhe menytrat provuese te parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.
2. Kur nje prove shkresore, nga e cila varet zgjidhja e ceshtjes ose qe ndikon ne sqarimin e saj, ka rrezik te manipulohet, zhduket ose te veshtiresohet marrja e saj, njesia pergjegjese kryesisht apo me kerkesen e sinjalizuesit, mund te vendose marrjen me pare te kesaj prove ose te urdheroje moskryerjen e asnje veprimi mbi keto dokumente (sigurimi i proves). Ne cdo rast mbahet nje procesverbal qe nenshkruhet nga anetaret e njesise pergjegjese dhe zyrtaret pergjegjes te organizates.
3. Gjate ushtrimit te detyres Njesia Pergjegjese zbaton, per aq sa mund te jete e pershtatshme, te gjitha mjetet dhe menytrat provuese te parashikuara ne Kodin e Procedurave Administrative.
4. Ne fund te kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nenshkruhet nga Njesia Pergjegjese dhe personat drejtues te shoqerise. Ne rast se keta te fundit nuk jane dakord me permbajtjen e aktit kane te drejte te bejne verejtje dhe te paraqesin kundershtime. Kopje te argumenteve dhe te dokumenteve kundershtime i bashkelidhen aktit.

### **Neni 12**

#### **Afati per vendimmarrjen**

1. Procedura e hetimit administrativ te sinjalizimit nga njesia pergjegjese perfundon

sa me shpejt te jete e mundur, por ne cdo rast, jo me vone se 60 dite nga data e fillimit te hetimit.

2. Shtyrja e afatit per hetimin administrativ behet me vendim te arsyetuar te njesise pergjegjese duke percaktuar edhe afatin e ri kohor te shtyrjes ne perputhje me veshtiresine dhe kompleksitetin e ceshtjes .

### **Neni 13**

#### **Perfundimi i hetimit administrativ dhe masat qe merren**

1. Njesia pergjegjese perfundon hetimin administrativ nese:
  - a. gjate hetimit rezulton se sinjalizimi per veprimin ose praktiken e dyshuar te korrupsionit eshte i bazuar;
  - b. konstaton se sinjalizuesi nuk ka vepruar ne kushtet e mirebesimit,
2. Nese ne perfundim te hetimit administrativ nga njesia pergjegjese rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar perben ose mund te perbeje nje shkelje administrative, sipas ligjit, njesia pergjegjese detyrohet te vere menjehere ne dijeni organin kompetent.
3. Njesia pergjegjese merr masa te menjehershme, te castit dhe per aq sa eshte e mundur, per te parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave te demshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit te sinjalizuar.
4. Ne dosjen e sinjalizimit shenohen vendimi per perfundimin e hetimit administrativ, i arsyetuar per te gjitha shkaqet qe kane çuar ne vendimmarrjen perkatese, si dhe masat e marra ne lidhje me sinjalizimin.

### **Neni 14**

#### **Njoftimi i sinjalizuesit**

1. Njesia pergjegjese njofton sinjalizuesin per cdo mase te marre ne pergjigje te sinjalizimit jo me vone se 30 dite nga momenti i kryerjes se veprimit.
2. Pavaresisht nga afati i njoftimit te parashikuar ne kete pike, njesia pergjegjese eshte e detyruar t'i pergjigjet brenda 30 diteve nga marrja e kerkeses per informacion, te paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, ne cdo kohe, ne lidhje me ceshtjen e sinjalizuar prej tij.

## Neni 15

### **E drejta e sinjalizuesit per t'u drejtuar drejtperdrejte ne ILDKPKI**

1. Sinjalizuesi ka te drejte te sinjalizoje vepren e dyshuar te korrupsionit prane ILDKPKI ne rastet kur:
  - a. Njesia pergjegjese nuk fillon hetimin administrativ ose perfundon hetimin ne kundershkrim me nenet 7 dhe 12 te kesaj Rregulloreje;
  - b. Ka dyshime te arsyeshme se pritesi i sinjalizimit ne njesine pergjegjese ose persona te lidhur me te jane perfshire ose kane interes te drejtperdrejte ose jo te drejtperdrejte, pasuror ose personal, ne veprimin ose praktiken e dyshuar te korrupsionit.
  - c. Ka arsye te tjera te bazuara per te dyshuar ne integritetin dhe paanshmerine e njesise pergjegjese ne shqyrtimin e sinjalizimit, sipas parimeve te ligjit dhe Rregullores;
9. Prova e sinjalizuesit, ne lidhje me veprimin ose praktiken e dyshuar te korrupsionit, mund te fshihet ose te shkaterrohet nga kompania.
2. Ne kete rast, nese njesia pergjegjese e ka filluar hetimin detyrohet ta nderpreste ate duke here shenimin perkates ne dosje.

## **KREU III**

### **MBROJTJA E KONFIDENCIALITETI**

## Neni 16

### **Konfidencialiteti**

1. Gjate procedures se hetimit administrativ te sinjalizimit, identiteti i sinjalizuesit u behet iditur personave te trete vetem me pelqimin e tij me shkrim.
2. Njesia pergjegjese duhet te ruaje ne cdo kohe ne menyre konfidenciale infonnacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e perhapur ose transmetuar tek persona te trete, si dhe të mos e perdorin per qellime te tjera, pervecse me pelqimin me shkrim te sinjalizuesit ose per permbushjen e nje detyrimi ligjor. Njesia pergjegjese ne komunikimet me organizatën ku punon sinjalizuesi ose me cdo

subjekt apo autoritet tjeter, privat ose shteteror, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshem vetem personave te caktuar per hetimin administrativ ose per marrjen e masave per ndjekjen e fakteve te sinjalizuara, ne kuader te nje marreveshje konfidencialiteti mes paleve.

#### Neni 17

#### Mbrojtja e të dhënave personale

1. Te dhenat personale te individeve të perfshire në hetimin administrativ përpunohen vetem per qellim te ligjit nr. 60/2016 "Per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve". Ne cdo rast,perpunimi i te dhenave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave te legjislacionit ne fuqi per mbrojtjen e te dhenave personale.
2. Ne rastet kur, ne zbatim te kesaj rregulloreje, konstatohet mosrespektim i legjislacionit per mbrojtjen e te dhenave personale, çeshtja i referohet menjehere Komisionerit per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
3. Kjo Rregullore hyn ne fuqi menjeherë.

#### RREGULLORE

#### PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT NË NJËSINË PËRGJEGJËSE TË SINJALIZIMIT

#### BASHKIA SHKODËR

Miratuar me datë: 13 / 12 / 2021 URDHER NR 1286

Struktura Pergjegjese e Sinjalizimit

Pëllumb ZOGU

Elmira Nehani

Kryetar i Bashkise Shkodër

Voltana ADEMI

